

LIGJ
Nr.9870, datë 4.2.2008
PËR STANDARDIZIMIN

*(Ndryshuar me ligjin nr. 10384, datë 24.2.2011, nr. 53/2015, datë 21.5.2015,
nr. 40/2020, datë 23.4.2020)*

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për:
 - a) zhvillimin e të gjitha veprimtarive të standardizimit në nivel kombëtar;
 - b) organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, si organi kombëtar i standardizimit në Shqipëri.
2. Qëllimi i këtij ligji është përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues në fushën e standardizimit, përfshirë dhe përgatitjen e publikimin e standardeve shqiptare, si dhe zbatimin e tyre.

Neni 2
Fusha e zbatimit
(Ndryshuar me ligjin nr. 10384, datë 24.2.2011)

1. Ky ligj zbatohet për standardet e hartuara e të adoptuara në të gjithë sektorët e ekonomisë.
2. Ky ligj nuk zbatohet për standarde të hartuara, të adoptuara dhe të miratuara nga shoqëri, agjenci dhe/ose organizata të pavarura.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Standardizim” është veprimtaria për krijimin, për probleme aktuale apo që mund të lindin, të rregullave/dispozitave, për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, për një nivel optimal rregull në një kontekst të dhënë. Në veçanti, veprimtaria ka të bëjë me proceset e përgatitjes, të publikimit dhe zbatimit të standardeve. Standardizimi është një veprimtari vullnetare, si rezultat i një konsensusi, i realizuar nga dhe për vetë palët e interesuara, bazuar në gjithëpërfshirje dhe transparencë.
2. “Organizëm kombëtar standardizimi” është organizmi i standardizimit, i njohur në nivel kombëtar, i cili, me ligj, gëzon të drejtën e përfaqësuesit kombëtar të organizatave homologe, ndërkombëtare dhe rajonale, të standardeve.
3. “Organizatë ndërkombëtare e standardizimit” është një organizëm standardizimi, anëtarësimi në të cilin është i hapur për organizmat kombëtarë, përkatës të çdo vendi.
4. “Organizatave europiane të standardizimit” janë Komiteti European i Standardizimit (CEN), Komiteti European i Standardizimit në Fushën e Elektroteknikës (CENELEC) dhe Instituti European i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI).

5. "Standard" është çdo dokument vullnetar, i hartuar me konsensus dhe i miratuar nga një organizëm i njohur standardizimi, i cili ofron, për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, rregulla, udhëzime ose karakteristika për veprimtari apo rezultatet e tyre, për një shkallë optimale rregulli, në një kontekst të dhënë.

6. "Standard ndërkombëtar" është çdo standard, i cili është adoptuar nga një organizatë ndërkombëtare standardizimi dhe që i është vënë në dispozicion publikut.

7. "Standard europian" (EN) është çdo standard vullnetar, i adoptuar nga njëra prej organizatave europiane të standardizimit dhe që i është vënë në dispozicion publikut.

8. "Dokument harmonizimi" (HD) është një dokument normativ vullnetar, i adoptuar nga njëra prej organizatave europiane të standardizimit, me detyrimin e zbatimit të përmbajtjes teknike në Shqipëri dhe shfuqizimin e standardeve kombëtare e të dokumenteve normative shqiptare, që bien ndesh me ato europiane.

9. "Standard i harmonizuar" është çdo standard europian (EN) ose një dokument harmonizimi (HD) i adoptuar nga njëra prej organizatave europiane të standardizimit, në zbatim të një mandati, të lëshuar nga Komisioni Europian, pas këshillimeve me vendet anëtare, numrat e referencës të të cilit publikohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.

10. "Standard shqiptar" është çdo dokument i miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, më poshtë DPS, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe që shënohet me (SSH).

11. "Standard shqiptar i harmonizuar" është çdo standard shqiptar, që ka adoptuar një standard europian të harmonizuar, sipas rregullave teknike.

12. "Dokument standardizimi" është çdo dokument, i miratuar nga organizmat europianë ndërkombëtarë dhe i adoptuar nga organizmat kombëtarë të standardizimit, siç janë specifikimet teknike, raportet teknike, manualët apo marrëveshjet e veçanta teknike, i cili është vënë në dispozicion të publikut.

13. "Programi i punës së standardizimit" është një program pune i një organizmi standardizimi, i cili përmban elementet e veprimtarisë së standardizimit për një periudhë të caktuar kohore.

14. "Referim tregues ndaj standardeve" është një referim ndaj standardeve, i cili përcakton se njëra nga mënyrat, për të përmbushur kërkesat përkatëse të një rregulli teknik, është zbatimi i standardit, referuar në aneksin e rregullit.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë kombëtare të standardizimit

Parimet e veprimtarisë kombëtare të standardizimit janë:

- a) e drejta e pjesëmarrjes vullnetare të të gjitha palëve të interesuara në hartimin, miratimin dhe adoptimin e standardeve shqiptare, si dhe në zbatimin vullnetar të tyre;
- b) konsensusi i të gjitha palëve të interesuara për përmbajtjen e standardeve shqiptare;
- c) transparenca në të gjitha fazat e punës së standardizimit, nëpërmjet publikimit e informimit të publikut;
- ç) parandalimi, që interesat individuale të mbizotërojnë ata të përgjithshëm;
- d) pjesëmarrja në punën europiane e ndërkombëtare të standardizimit, zbatimin e standardeve europiane e ndërkombëtare si standarde shqiptare.

Neni 5

Qëllimi i veprimtarisë së standardizimit

Qëllimi i veprimtarisë së standardizimit është:

- a) të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, si dhe mjedisin, duke ndihmuar në zbatimin e legjisllacionit, në funksion të kërkesave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurisë e shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, duke siguruar, në këtë mënyrë, rregulla të përbashkëta;
- b) të promovojë cilësinë e produkteve, të proceseve dhe të shërbimeve;
- c) të sigurojë përdorimin me efektivitet të punës, të materialeve dhe të energjisë;
- ç) të përmirësojë efektshmërinë e produkteve, të kontrolleve të ndryshme, duke siguruar përputhshmërinë dhe ndërveprimin;
- d) të ndihmojë në heqjen e barrierave teknike në tregtinë ndërkombëtare.

Neni 6

Identifikimi i standardeve shqiptare

1. Standardet shqiptare identifikohen me emërtim shkronjash dhe numrash. Emërtimi do të përmbajë shkronjat "SSH" apo një ndërthurje të shkronjave "SSH" me shkronja të tjera, sipas origjinës, në rastet e zbatimit të standardeve europiane ose ndërkombëtare. Pjesa numerike përmban numrin e standardit dhe vitin e miratimit të tij.

2. Këto emërtime nuk përdoren nga standarde të tjera, që krijohen nga shoqëri apo entitete të tjera në Republikën e Shqipërisë, përveç DPS-së.

Neni 7

Zbatimi i standardeve shqiptare

1. Zbatimi i standardeve shqiptare është vullnetar.

2. Standardet shqiptare janë të njëjta për të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë.

3. Një rregull teknik, i cili përmban kërkesa thelbësore, mund t'u referohet standardeve shqiptare ose pjesëve të tyre, vetëm atëherë kur ky rregull teknik transpozon direktiva të Bashkimit Europian. Referimi ndaj këtyre standardeve duhet bërë si "Standarde shqiptare të harmonizuara".

4. Standardet shqiptare të harmonizuara, të miratuara nga DPS-ja, pas këshillimeve dhe me propozimin e ministrit dhe të autoriteteve të tjera ekzekutive, i propozohen Këshillit të Ministrave për miratim me listë me rregullat teknike përkatëse. Lista e standardeve shqiptare të harmonizuara, si dhe çdo rishikim i tyre publikohen në Fletoren Zyrtare. Çdo referim ligjor ndaj standardeve shqiptare të harmonizuara do të ketë karakter tregues.

5. Ministritë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor, të cilat përgatisin rregulla teknike, që përmbajnë referime ndaj standardeve shqiptare ose pjesëve të këtyre standardeve, për zbatim në nivel kombëtar, bashkëpunojnë me DPS-në për mënyrën e referimit.

6. Një rregull teknik do t'u referohet standardeve shqiptare, të cilat adoptojnë standarde europiane ose ndërkombëtare, vetëm nëse këto standarde janë adoptuar nga DPS-ja dhe janë publikuar si standarde shqiptare në njërin nga dokumentet e saj.

KREU II

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Neni 8

Organi kombëtar i standardizimit

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10384, datë 24.2.2011)

(Shfuqizuar pika 3 dhe ndryshuar fjalia 2 e pikes 4 me ligjin nr. 53/2015, datë 21.5.2015, ndryshuar pika 5 dhe shtuar pika 7 me ligjin nr. 40/2020, datë 23.4.2020)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit është organizmi kombëtar i standardizimit në Republikën e Shqipërisë për hartimin, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve në të gjithë sektorët e ekonomisë.

2. DPS-ja është person juridik, publik, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe e ka qendrën në Tiranë.

3. Shfuqizuar

4. Struktura dhe organika e DPS-së propozohen nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe miratohen nga Kryeministri. Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe nëpunësve të DPS-së rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administativë rregullohen me Kodin e Punës.

5. DPS-ja është Autoriteti Kombëtar i Notifikimit dhe Pika Kombëtare e Referimit në OBT dhe në CEFTA për projektstandartet, projektregullat teknike dhe projektprocedurat e vlerësimit të konformitetit me ndikim në tregti. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është Autoriteti Kombëtar i Notifikimit dhe Pika Kombëtare e Referimit në OBT për masat sanitare dhe fitosanitare me ndikim në tregti.

Autoriteti Kombëtar i Notifikimit, gjatë ushtrimit të këtij funksioni, informon periodikisht njësinë e OBT-së pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, për çdo notifikim të saj pranë OBT-së dhe CEFTA-s.

6. DPS-ja është institucion buxhetor, me buxhet më vete. DPS-ja, të ardhurat e përftuara nga shërbimet e veta, do t'i përdorë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit është Administratori Kombëtar i Regjistrimit për Lëshuesit (NRA/I).

Neni 9

Përfaqësimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 10384, datë 24.2.2011)

DPS-ja përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO), në Komisionin Ndërkombëtar të Elektroteknikës (IEC), në Sektorin e Standardizimit të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU-T), në Komitetin European për Standardizimin (CEN), në Komitetin European për Standardizimin në Fushën e Elektroteknikës (CENELEC) dhe në Institutin European të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI).

Neni 10

Organet drejtuese

1. Organet drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit janë bordi drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm.

2. Krijimi, përbërja, kompetencat dhe funksionimi i bordit drejtues të DPS-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Bordi teknik

1. Bordi teknik është organ teknik i DPS-së dhe nuk bën pjesë në organikë.

2. Në bordin teknik marrin pjesë vullnetarisht përfaqësues nga palët e interesuara për standardizimin.

3. Përbërja, kompetencat dhe funksionimi i bordit teknik miratohen nga bordi drejtues.

Neni 12

Komitetet teknike

1. Komitetet teknike të standardizimit janë organizmat e punës së DPS-së, që nuk bëjnë pjesë në organikë dhe aktivizohen për fusha të caktuara të standardizimit.

2. Komitetet teknike krijohen dhe shpërndahen nga bordi teknik.

3. Pjesëmarrja në komitetet teknike është vullnetare, e hapur për të gjitha palët e interesuara dhe pa pagesë.

Neni 13

Anëtarësimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 10384, datë 24.2.2011)

1. "Forumi Kombëtar i Standardizimit" është organ pranë DPS-së. Anëtar i këtij forumi mund të bëhet çdo person fizik dhe/ose juridik, që ushtron veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Forumit Kombëtar të Standardizimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të tij përcaktohen me rregullore të veçantë të hartuar nga DPS-ja dhe të miratuar nga bordi drejtues i saj.

Neni 14

Kompetencat

(Shfuqizuar shkronja "g" me ligjin nr. 53/2015, datë 21.5.2015, shtuar fjalë në pikat "ë" dhe

“f”, si dhe shtuar pika “f/1” me ligjin me ligjin nr. 40/2020, datë 23.4.2020)

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ushtron këto kompetenca:

- a) harton dhe miraton rregullat dhe procedurat e punës për veprimtaritë kombëtare të standardizimit, në zbatim të veprimtarive të organizatave europiane të standardizimit;
- b) përgatit, miraton dhe publikon programin e punës së standardizimit, në përputhje me interesat e palëve të interesuara për standardizimin;
- c) harton, adopton, miraton, zbaton, ndryshon, shfuqizon, publikon standardet shqiptare dhe dokumentet shqiptare të standardizimit;
- ç) adopton dhe publikon standardet europiane dhe ndërkombëtare në fuqi si standarde shqiptare;
- d) zbaton parimet dhe rregullat e ndjekura nga organizatat europiane dhe ndërkombëtare të standardizimit;
- dh) përgatit dhe mirëmban bazën e të dhënave për standardet dhe dokumentet e standardizimit;
- e) përgatit dhe mirëmban arkivin me standarde kombëtare, ndërkombëtare, europiane, standardet kombëtare të huaja, si dhe një mjedis të specializuar për shitjen e tyre;
- ë) ofron shërbime informacioni për tregun e brendshëm dhe atë unik europian, në përputhje me kërkesat e organizmave vendas dhe të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj;
- f) zbaton detyrimet si Autoritet Notifikues dhe Pikë Referimi, të cilat rrjedhin si rezultat i marrëveshjes me Organizatën Botërore të Tregtisë për barrierat teknike në tregti dhe të kodit të praktikës së mirë për hartimin, adoptimin dhe zbatimin e standardeve dhe Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Europën Qendrore (CEFTA);
- f/1) zbaton detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i direktivave dhe i rregulloreve të Bashkimit European për standardizimin dhe fushat që lidhen me të, si dhe është pikë kontakti për dhënien e informacionit për disa nga produktet që vendosen në treg.
- g) Shfuqizuar;
- gj) shkëmben informacion dhe bashkëpunon në fushën e standardizimit me organizma kombëtarë të standardizimit të vendeve të tjera;
- h) organizon trajnime dhe veprimtari për standardizimin;
- i) publikon buletin dhe katalogun e standardeve shqiptare në periudha të përcaktuara;
- j) publikon raportin vjetor të veprimtarive në vitin pararendës;
- k) nxit studimet, publikimet, përvojën dhe punën kërkimore për standardizimet, si dhe veprimtari të tjera, që kanë lidhje me standardizimin;
- l) i propozon ministrisë përgjegjëse për ekonominë aktet ligjore dhe nënligjore për veprimtaritë që mbulon;
- ll) i propozon Ministrisë së Financave tarifat për çmimet e shërbimeve, që kryhen për palët e treta, bazuar në tarifat e organizatave ndërkombëtare e europiane dhe kushtet e vendit.

Neni 15

Hartimi, adoptimi, miratimi dhe publikimi i standardeve shqiptare

1. Çdo person fizik dhe/ose juridik mund t'i paraqesë DPS-së një propozim, të shoqëruar me arsyetimin përkatës, për hartimin, adoptimin dhe miratimin e një standardi shqiptar.

Procedura e hartimit, adoptimit dhe miratimit të standardeve shqiptare duhet të përcaktojë:

- a) objektivat që duhen arritur nga standardi i propozuar;
- b) faktorët dhe ndikimin ekonomik;
- ç) burimet e financimit dhe të ekspertizës;
- ç) zbatimet e mundshme të standardit, në kuadër të vlerësimit të konformitetit;
- d) lidhjet me standardet e tjera.

2. Standardet europiane dhe ndërkombëtare janë të gatshme për përdorim publik, nëpërmjet adoptimit të tyre si standarde shqiptare.

3. Standardet europiane e ndërkombëtare zbatohen në të njëjtën mënyrë si standarde shqiptare, nëpërmjet:

a) adoptimit, miratimit dhe përgatitjes së një teksti të njëjtë me origjinalin e standardit në gjuhën shqipe;

b) hartimit të faqes së parë në gjuhën shqipe;

c) miratimit me listë si standarde shqiptare.

4. Konfirmimi i miratimit si standarde shqiptare bëhet nëpërmjet përgatitjes së një dokumenti zyrtar miratimi, si dhe me shpalljen në buletin periodik të DPS-së.

5. Me adoptimin e standardeve europiane si standarde shqiptare, çdo standard shqiptar apo akt tjetër normativ, që bie ndesh me ato europiane, shfuqizohet.

6. Procedura për adoptimin e standardeve europiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare përcaktohet në rregullat dhe procedurat për veprimtaritë kombëtare të standardizimit.

7. Hartimi, adoptimi, miratimi dhe publikimi i standardeve shqiptare bëhen në përputhje me rregullat dhe procedurat për veprimtaritë kombëtare të standardizimit.

Neni 16

Hartimi, adoptimi dhe miratimi i dokumenteve shqiptare të standardizimit

1. Dokumentet shqiptare të standardizimit hartohen, adoptohen dhe miratohen sipas rregullave dhe procedurave për veprimtaritë kombëtare të standardizimit.

2. Dokumentet shqiptare të standardizimit identifikohen nëpërmjet emërimit me shkronja dhe numra. Emërtimi me shkronja përbëhet nga shkronjat "DS" (Dokument standardizimi), ose në një kombinim të shkronjave DS dhe emërtime të tjera me shkronja, në rastet e adoptimit të dokumenteve europiane ose ndërkombëtare të standardizimit. Emërtimi numerik përbëhet nga numri i dokumenteve të standardizimit dhe viti i miratimit apo adoptimit të tyre. Këto emërtime nuk do të përdoren për dokumente të tjera standardizimi, përveç dokumenteve shqiptare të standardizimit.

Neni 17

Konfirmimi, ndryshimi, ripunimi dhe shfuqizimi i standardeve shqiptare dhe i dokumenteve shqiptare të standardizimit

1. DPS-ja kontrollon periodikisht dhe konfirmon statusin e standardeve shqiptare, në përputhje me rregulloren e brendshme të saj.

2. Konfirmimi, ndryshimi, ripunimi dhe shfuqizimi i një standardi shqiptar apo i një dokumenti shqiptar të standardizimit realizohen në përputhje me rregullat dhe procedurat e veprimtarive kombëtare të standardizimit.

Neni 18

E drejta e autorit, e drejta e shitjes dhe pronësia intelektuale

1. E drejta e autorit për formën dhe përmbajtjen e çdo standardi shqiptar apo dokumenti standardizimi i takon DPS-së.

2. DPS-ja ka të drejtën ekskluzive dhe pronësinë intelektuale për publikimin, riprodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e projektstandardeve dhe standardeve shqiptare, të projektdokumenteve dhe të dokumenteve shqiptare të standardizimit.

3. DPS-ja mund të caktojë agjentë apo shpërndarës për shitjen ose shpërndarjen e standardeve shqiptare dhe të dokumenteve shqiptare të standardizimit, me anë të marrëveshjeve me palët.

KREU III FINANCIMI

Neni 19

Burimet e financimit të DPS-së

(Ndryshuar shkronja "dh" me ligjin nr. 10384, datë 24.2.2011)

Të ardhurat buxhetore të DPS-së sigurohen nga:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) shitja e standardeve shqiptare dhe të huaja, e projektstandardeve shqiptare dhe të huaja, nga shitja e katalogut, dokumenteve dhe publikimeve të standardizimit;
- c) shërbimet e kryera, përfshirë informacionin dhe trajnimin;
- ç) pjesëmarrja në programe donatorësh dhe/ose projekte, që kanë qëllime të caktuara financimi, qofshin këto europiane, ndërkombëtare apo të çdo lloji tjetër;
- d) donacione apo grante nga personat fizikë dhe/ose juridikë;
- dh) kuotat nga anëtarësimi në Forumin Kombëtar të Standardizimit pranë DPS-së.

KREU IV SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 20 **Kundërvajtjet administrative**

Rastet e shkeljeve të dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) çdo person fizik apo juridik, që pretendon pronësinë intelektuale dhe riprodhon, regjistron ose publikon, në çdo mënyrë ose formë, standarde apo projektstandarde shqiptare ose dokumente të standardizimit dhe i shet ato në kundërshtim me pikën 2 të nenit 18 “E drejta e autorit, e drejta e shitjes dhe pronësia intelektuale” të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë;

b) çdo person fizik apo juridik, që vepron në kundërshtim me pikën 3 të nenit 18 “E drejta e autorit, e drejta e shitjes dhe pronësia intelektuale” të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 300 000 lekë.

Neni 21 **Ankimi**

Kundërvajtësi, brenda 5 ditëve nga vënia e gjobës, mund të bëjë ankim në gjykatë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 22 **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në përputhje me nenet 8 pika 5, 10 pika 2, 14 pika 1 shkronjat “f” dhe “g” të këtij ligji, të nxjerrë akte nënligjore.

Neni 23 **Vlefshmëria e standardeve shqiptare**

Standardet shqiptare, të emërtuara me shkronjat “SSH”, të cilat janë miratuar ose adoptuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, e ruajnë vlefshmërinë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 24 **Shfuqizime**

Ligji nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5625, datë 18.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi